

## **Nënkomiteti i 13-të BE-Shqipëri për Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale**

**Tiranë, Shqipëri, 27/01/2022**

Njoftim për shtyp

Takimi i 13-të i Nënkomitetit për tema që lidhen me Arsimin, Kërkimin dhe Inovacionin, Shoqërinë e Informacionit dhe Politikën Sociale ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u mbajt më 27 janar. Përfaqësues nga Komisioni Evropian (Komisioni) diskutuan me autoritetet përkatëse shqiptare mbi zhvillimet më të fundit në këto fusha. Takimi u bashkëkryesua për BE-në nga znj. Michela Matuella, Shefe e Njesisë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, në Drejtorinë e Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Negociatat e Zgjerimit të Komisionit Evropian, ndërsa për Shqipërinë nga znj. Enkelejda Muçaj, Zëvendësministre e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Komisioni vlerësoi përpjekjet e bëra nga autoritetet shqiptare për të kapërcyer pasojat e pandemisë në tregun e punës, si dhe në sektorët e arsimit dhe kulturës, veçanërisht në lidhje me grupet më të cenueshme. Ai nënvizoi nevojën e rritjes së alokimit financiar për politikën e punësimit, mbrojtjen sociale, arsimin, kërkimin dhe inovacionin, si dhe rolin e rëndësishëm të teknologjive digjitale në mbështetjen e ekonomisë dhe zbutjen e efekteve të pandemisë.

Komisioni vlerësoi përpjekjet e bëra nga Shqipëria gjatë vitit 2021 në fushën e punësimit dhe të tregut të punës, si dhe progresin që është bërë për zhvillimin e Skemës së Garancisë Rinore. U nënvizua rëndësia e zbatimit të legjislacionit të miratuar përmes forcimit të kontrollit të standardeve të punës, si dhe burimeve të mjaftueshme njerëzore për politikën e punësimit dhe formimit profesional. Komisioni vlerësoi udhërrëfyesin për përshtatjen e mjaftueshmërisë së përfitimeve nga Ndihma Ekonomike dhe krijimin e një mekanizmi për rishikimin e tyre vjetor, si dhe e nxiti Shqipërinë ta zbatojë atë në kohën e duhur. Komisioni e nxiti Shqipërinë që të bëjë përpjekje për trajtimin e punës së fëmijëve, si dhe për zbatimin e strategjisë për mbrojtjen sociale, duke mbështetur qeverisjen vendore për përshtatjen e reformës së shërbimeve sociale.

U vlerësua ecuria shumë e mirë e Shqipërisë në vitin e fundit të programit “Horizon 2020”. Komisioni i nxiti autoritetet shqiptare që të rrisin përpjekjet për të finalizuar dhe miratuar Strategjinë e Specializimit Smart, si dhe vlerësoi procesin efikas të pjesëmarrjes në “Horizon Europe”. Komisioni nënvizoi nevojën për miratimin e amendamenteve të nevojshme të Ligjit për Komunikimet Elektronike, në përputhje me Kodet e reja Evropiane të Komunikimeve Elektronike, si dhe për të finalizuar dhe miratuar Agjendën Digjitale.

Komisioni vlerësoi miratimin e Strategjisë 2021 – 2026 për arsimin dhe i nxiti autoritetet që të rrisin alokimin financiar për trajnimin e vazhdueshëm mbi mësimdhënien. Komisioni theksoi nevojën për finalizimin dhe miratimin e Strategjisë Kombëtare për Rininë për periudhën 2022 – 2029, si dhe miratimin e të gjitha akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Rininë.